

POLITIKA E PRIVATËSISË

Përditësimi i fundit: Korrik 2025

SHËRBIMET, FAQET E INTERNETIT DHE APLIKACIONET E HILTI

Hilti ka një reputacion jo vetëm për ofrimin e produkteve cilësore dhe shërbimit të shkëlqyer për klientët, por është gjithashtu e përkushtuar për të mbrojtur privatësinë tuaj.

Pavarësisht nëse jeni përdorues i ri i shërbimeve Hilti apo i keni përdorur ato për një kohë të gjatë, ju lutemi lexoni me kujdes këtë njoftim. Nëse keni një shqetësim, ankesë apo pyetje në lidhje me mënyrën se si trajtojmë të dhënat tuaja personale, ju lutemi kontaktoni Zyrën për Mbrojtjen e të Dhënave të Hilti duke përdorur formularin tonë në internet.

Kjo Politikë e Privatësisë nuk zbatohet për aktivitetet e kompanive apo individëve të tjerë, përfshirë ofertat e tyre të shërbimeve si produkte apo faqe interneti që mund të ju shfaqen në rezultatet e kërkimeve, reklamat për produktet apo shërbimet e Hilti, faqet që mund të përfshijnë shërbime të Hilti-t, ose faqe të tjera të lidhura nga shërbimet tona.

Kjo Politikë e Privatësisë përshkruan mënyrën se si ne mbledhim, përpunojmë dhe përdorim të dhënat tuaja personale në cilësinë tonë si kontrollues i të dhënave, si për shembull gjatë përdorimit të Hilti Online. Kur klientët tanë përdorin disa shërbime apo aplikacione të Hilti-t, ne mund të përpunojmë të dhënat personale të përdoruesve të autorizuar të tyre, në emër të klientit si përpunues të dhënave. Në këto raste, klienti është kontrolluesi i të dhënave dhe përgjegjës për shumicën e aspekteve të përpunimit. Si e tillë, kjo Politikë e Privatësisë nuk zbatohet për aktivitetet e Hilti-t si përpunues i të dhënave. Përshkrime të detajuara të aktiviteteve tona të përpunimit si përpunues të dhënave gjenden në kushtet kontraktuale që zbatohen për aplikacionin apo shërbimin përkatës.

Adresa e zyrës qendrore është:

Hilti Aktiengesellschaft (Hilti “AG”)

Feldkircherstrasse 100,

9494 Schaan

LIECHTENSTEIN

Përveç Hilti AG, pala juaj kryesore lokale është subjekti me të cilin po lidhni kontratë (p.sh., subjekti i listuar në kontratën ose faturën tuaj). Shihni seksionin 2 për një listë të plotë të entiteteve të Hilti-t.

Termi “të dhëna personale”, ashtu siç përdoret në këtë Politikë të Privatësisë, nënkupton çdo informacion që lidhet me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm (“subjekti i të dhënave”) – pavarësisht nëse ky informacion është dhënë nga ju apo është marrë në mënyrë tjetër. Një person fizik i identifikueshëm është ai që mund të identifikohet, drejtpërdrejt ose tërthorazi, përmes një identifikuesi si emri, një numër identifikimi Hilti, apo identifikues të tjerë teknikë online.

Përmbajtja

1. Informacion specifik për entitetin tuaj lokal të Hilti-t
2. Kush është kontrolluesi i të dhënave për të dhënat tuaja personale dhe përgjegjës për trajtimin e tyre të duhur?
3. Çfarë lloje të të dhënave personale mbledh, përpunon dhe përdor Hilti?
4. Pse dhe me kë i ndajmë të dhënat personale?
5. A do të transferohen të dhënat personale jashtë vendit dhe nëse po, si do të mbrohen?
6. Për çfarë qëllimesh i përdorim të dhënat personale?
7. Për sa kohë i ruajmë të dhënat personale?
8. Çfarë zgjedhjesh për privatësinë keni?
9. Çfarë bëjmë për të mbrojtur të dhënat tuaja personale?
10. Politika për Cookies – Informacion mbi përdorimin e cookies dhe teknologjive të ngjashme
 - Cookies funksionale / teknike për performancë
 - Cookies jo-thelbësore
 - Partnerët tanë të besuar për gjurmim dhe reklamim
11. Lidhje me faqe të tjera jo të Hilti-t
12. Përputhshmëria dhe bashkëpunimi me autoritetet rregullatore
13. Si komunikohen ndryshimet në këtë Politikë të Privatësisë?
14. Na kontaktoni

1. Informacion specifik për entitetin tuaj lokal të Hilti-t

HILTI ALBANIA Sh.p.k.

Rruga "Sami Frasheri", Kompleksi TID, Shkalla F, K. 1, Tiranë Shqipëri

Të dhënat e kontaktit të Zyrës sonë për Mbrojtjen e të Dhënave janë:

HQ-DPO@hilti.com

Autoriteti kombëtar për mbrojtjen e të dhënave është:

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Kjo Politikë e Privatësisë bazohet në kërkesat e Rregullores së Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave ("GDPR"). Grupi Hilti e zbaton standardin e GDPR-së si bazë globale, në përputhje me Rregullat e Detyrueshme të Korporatës ("BCR") që synojnë të ruajnë praktika të nivelit të lartë për mbrojtjen e të dhënave. Megjithatë, Hilti gjithashtu respekton ligjin lokal për mbrojtjen e të dhënave kudo që ai ndryshon apo ofron një nivel më të lartë mbrojtjeje sesa GDPR.

Ligji juaj lokal për mbrojtjen e të dhënave është:

LIGJ

Nr. 124/2024

2. Kush është kontrolluesi i të dhënave për të dhënat tuaja personale dhe përgjegjës për trajtimin e tyre të duhur?

Hilti AG vepron si kontrollues i të dhënave dhe është përgjegjës për mbledhjen, përpunimin dhe përdorimin e të dhënave personale si ofrues i shërbimeve, faqeve të internetit dhe aplikacioneve, në shumicën e rasteve dhe në varësi të shërbimit të kërkuar, së bashku me një ose më shumë nga degët e saj. Për një listë të plotë të entiteteve të Hilti-t dhe për të mësuar më shumë rreth marrëdhënies midis Hilti-t dhe degëve të saj, ju lutemi shihni Rregullat tona të Detyrueshme të Korporatës (BCR).

3. Çfarë lloje të të dhënave personale mbledh, përpunon dhe përdor Hilti?

Tabela më poshtë përshkruan llojet e të dhënave personale që mund të mbledhim, përpunojmë dhe përdorim në lidhje me shërbimet, faqet tona të internetit dhe aplikacionet. Kjo përfshin jo vetëm informacionin që mbledhim në mënyrë aktive gjatë ndërveprimit tonë me ju, por edhe informacionin që na jepni përmes ekipit tonë të shërbimit ndaj klientit, punonjësve të dyqaneve Hilti apo ekipit të shitjeve. Për më tepër, përfshin të dhëna që mund të marrim nga burime publike ose nga palë të treta të besuara.

Ju keni mundësi të zgjidhni nëse do të përdorni shërbimet tona, të vizitoni faqet tona të internetit, të instaloni aplikacionet tona ose të na jepni të dhëna personale. Megjithatë, në disa raste, nëse nuk na jepni disa të dhëna specifike personale, mund të mos jeni në gjendje të përdorni pjesë të caktuara të shërbimeve apo faqeve tona. Gjithashtu, në disa raste mund të jemi të detyruar ligjërisht të mbledhim të dhëna të caktuara personale nga ju për të zbatuar marrëveshjen përkatëse për përdorimin e aplikacioneve apo shërbimeve tona të tjera.

Kategoritë e të dhënave personale që mbledhim dhe përpunojmë ndryshojnë në varësi të faktit nëse jeni përdorues i regjistruar apo i paregjistruar i shërbimeve, faqeve të internetit apo aplikacioneve tona. Shembuj të të dhënave për secilën kategori gjenden në tabelën e mëposhtme:

Lloji i Subjektit të të Dhënave	Identifikues dhe Të Dhëna Kontakti	Të Dhëna Komerciale dhe Transaksionesh	ë Dhëna për Pajisjen, Përdorimin dhe të Dhëna Teknike	Të Dhëna Lokacioni	Të Dhëna Komunikimi
PËRDORUES I PAREGJISTRUAR i shërbimeve, faqeve të internetit dhe aplikacioneve tona	Cookies që identifikojnë në mënyrë unike shfletuesin tuaj; Emri i përdoruesit në rrjetet sociale; dhe Foto profili.		Preferenca të përdoruesit (p.sh., gjuhë e preferuar); Skedarë log automatik për qëllime të sigurisë dhe diagnostikimi (p.sh., për të monitoruar dhe parandaluar kërcënimet IT), dhe në raste të veçanta, analiza manuale e log-eve nga ne ose ofruesit tanë të autorizuar; Emri, URL dhe sasia e të dhënave të transferuara për skedarin e kërkuar, dhe nëse kërkesa ishte e suksesshme; Rezolucioni i ekranit dhe thellësia e ngjyrave; Adresa IP, sistemi operativ, tipi i shfletuesit, versioni, konfigurimi, dhe shtesat e instaluara; Emri i ofruesit të shërbimit të internetit, dhe informacion tjetër në lidhje me pajisjen dhe lidhjen. Për pikat e mëposhtme të të dhënave, regjistrohet gjithashtu data dhe ora e kërkesës: URL dhe adresa IP e faqes nga e cila keni hyrë ose jeni drejtuar në faqen tonë; Nënfaqe të vizituara, funksione të përdorura, lidhje të ndjekura dhe kohë e kaluar në faqe – për faqet dhe aplikacionet tona; Informacion për ngjarjet e pajisjes si p.sh. crash-e, aktiviteti i sistemit, dhe cilësimet e harduerit; dhe Dërgimi dhe hapja e njoftimeve për aplikacionet tona.		
PËRDORUES I REGJISTRUAR ose KLIENT i shërbimeve, faqeve të internetit dhe	Emri dhe mbiemri; Titulli/roli profesional;	Historia e blerjeve, duke përfshirë transaksione të hapura dhe të përfunduara;	Të gjitha të dhënat e Pajisjes, Përdorimit dhe Teknike të mbledhura për përdoruesit e paregjistruar (të listuara më sipër) si dhe pikat e mëposhtme: Termat e kërimit të futur;	Vendndodhje relative, përmes teknologjive të ndryshme për të përcaktuar vendndodhjen deri në	Përmbajtja e çdo komunikimi të dërguar përmes shërbimeve, faqeve dhe aplikacioneve tona, përfshirë çdo informacion të publikuar në komunitete sociale në faqet publike ose ndarë me Hilti dhe/ose përdorues të tjerë;

aplikacioneve tona	Numri i telefonit dhe faksit; Adresa e emailit; Adresa fizike; Emri i përdoruesit dhe fjalëkalimi; ID kontakti (identifikues teknik unik); Vetë-përcaktim si përdorues privat ose profesional; Shteti; dhe Gjuha.	Kërkesa për shërbime dhe porosi të bëra; Informacion për pagesa dhe bankë; Regjistrime të TVSH-së dhe taksave doganore; Pjesëmarrje në fushata ose evente; Pajtime në buletine, regjistrime për promovime, përdorim i ofertave speciale; Pëlqime dhe autorizime të dhëna; Regjistrim, progres dhe status përfundimi për çdo porosi apo shërbim (p.sh., përfundimi i trajnimit për punonjësit e klientit); dhe Data e kontaktit të fundit.	Shërbimet/produktet e shikuara ose të kërkuara në faqe dhe softuer i shkarkuar; Numri unik i aplikacionit; dhe Nëse përdorni versionin mobil të shërbimeve, faqeve dhe aplikacioneve: informacion mbi modelin e pajisjes dhe sistemin operativ, rrjeti përfshirë numrin e telefonit të pajisjes suaj, versioni i shërbimeve, faqeve dhe aplikacioneve të përdorura, ofruesi i shërbimit të internetit dhe lloje të tjera informacioni të lidhur me pajisjen dhe lidhjen, të rëndësishme për përmirësimin e shërbimeve mobile, lidhjen me serverët tanë, aktivizimin dhe mbështetjen e sinkronizimit të aplikacioneve mobile. Hilti mund të lidhë identifikuesit e pajisjes suaj ose numrin e telefonit me Llogarinë tuaj Hilti.	nivel qyteti, përfshirë adresën IP.	Transkriptet e bisedave; Regjistrimet telefonike dhe transkriptet për thirrjet me shërbimin ndaj klientit Hilti; Përgjigjet e sondazheve, vlerësimet, komentet dhe lloje të tjera reagimesh të dhëna në komunikim me Hilti (me email, chat, telefon apo SMS); dhe Të dhëna personale të përfshira në kontrata, komunikime dhe letra biznesi.
---------------------------	--	---	---	--	--

4. Pse dhe me kë i ndajmë të dhënat personale?

Ne nuk i shesim, nuk i tregojmë dhe nuk i japim me qira të dhënat tuaja personale.

Për qëllimet e përmendura në seksionin 6 të kësaj Politike të Privatësisë, ne i zbulojmë, i transferojmë ose në mënyra të tjera i ndajmë të dhënat tuaja personale me entitete të tjera të Grupit Hilti në masën e përshkruar në seksionin 5 ose siç keni rënë dakord ju në një kontekst të veçantë (p.sh., kur jepni pëlqimin për transferime të tjera të të dhënave në lidhje me regjistrimin për një shërbim të caktuar). Për një listë të plotë të entiteteve Hilti, shih seksionin 2. Kurdoherë që ndajmë të dhëna personale, respektojmë rreptësisht ligjin në fuqi.

Ne mund t'i ndajmë të dhënat personale me kompani, organizata ose individë jashtë Grupit Hilti si më poshtë (me pëlqimin tuaj paraprak kur kërkohet sipas ligjit në fuqi):

Ofruesit e Shërbimeve: Ne i japim të dhënat tuaja personale ofruesve të palëve të treta për të ofruar, mbështetur dhe përmirësuar produktet dhe shërbimet tona, përfshirë infrastrukturën tonë teknike. Këto kompani ofrojnë shërbime si: hostimi i të dhënave, zhvillimi dhe mirëmbajtja e faqeve të internetit, konfigurimi dhe parametrizimi i faqeve, krijimi i formave në ueb, transportues të mallrave, sisteme CRM dhe CMP, mjete për mbledhjen e komenteve të klientëve, kërkime cilësore, sisteme autentifikimi, zbulimi i mashtrimeve dhe mbështetje për klientët. Çdo ofrues shërbimi ka akses vetëm në të dhëna personale të nevojshme për kryerjen e detyrës së tij specifike dhe vetëm për këtë qëllim. Ne sigurojmë që të jenë vendosur masa të përshtatshme kontraktuale me çdo ofrues, që i detyrojnë ata të zbatojnë standarde të duhura sigurie dhe konfidencialiteti, siç kërkohet nga ligji për mbrojtjen e të dhënave.

Partnerët për Reklama, Marketing dhe Analizë: Hilti përdor teknologji të palëve të treta për reklama, marketing dhe analizë, përfshirë ato që mbështesin përpjekjet tona në marketing (p.sh., rrjete reklamuese, shërbime matëse reklame dhe ofrues të analizave, ofrues të rimarketingut, etj.) për të: ofruar statistika dhe analiza mbi mënyrën si përdoruesit përdorin produktet dhe shërbimet tona, përfshirë faqet tona të internetit, dhe për t'ju shfaqur reklama, përfshirë përmbajtje të synuar në faqet tona dhe në faqe të tjera që vizitoni. Këta partnerë të palëve të treta mund të marrin informacion për ju ose për aktivitetet tuaja në faqen tonë të internetit drejtpërdrejt nga ne ose përmes cookies të palëve të treta të vendosura në faqen e Hilti (shih seksionin 10).

Përpunuesit e Pagesave: Kur kryeni një pagesë për produkte ose shërbime të Hilti, ne ia zbulojmë detajet e pagesës përpunuesit të pagesës së zgjedhur nga ju.

Përmbajtje e Gjeneruar nga Përdoruesi: Kur komentoni ose postoni në faqet tona në rrjetet sociale ose në forumet e komunitetit, ky informacion mund të shihet, mbledhet ose përdoret gjithashtu nga palë të treta.

Punëdhënësi ose Organizata juaj: Kur krijoni një llogari me një adresë emaili të caktuar nga punëdhënësi juaj, kontraktori ose organizata (p.sh., emriyyt@punedhenesi.com), kjo organizatë mund ta gjejë llogarinë tuaj dhe të ndërmarrë veprime në lidhje me cilësimet dhe autorizimet e saj.

Transaksione Korporative: Ne mund të ndajmë të dhënat tuaja personale me blerës aktualë ose të mundshëm, përfaqësuesit e tyre dhe pjesëmarrës të tjerë përkatës në rastin e një (ose si pjesë e due diligence për një) riorganizimi, shitjeje, bashkimi, konsolidimi, ndërmarrjeje të përbashkët, transferimi ose ndryshimi kontrolli që përfshin të gjithë ose një pjesë të biznesit ose pasurive të Hilti, përfshirë në rast falimentimi ose procedura të ngjashme. Në rast të një transaksioni të tillë, ne do të përpiqemi maksimalisht t'ju njoftojmë për çdo ndryshim në kontrollin e të dhënave tuaja personale dhe për opsionet që mund të keni.

Për Shkak të Kërkesave Ligjore: Pa kufizim, kjo përfshin raste kur jemi të detyruar të ndajmë të dhëna personale për të përmbushur një detyrim ligjor, ose për t'iu përgjigjur një urdhri gjyqësor detyrues, një procesi administrativ ose gjyqësor si p.sh. thirrje në gjyq apo auditim nga qeveria, ose një kërkesë nga autoritetet ligjzbatuese apo rregullatore. Nëse vendosim të zbulojmë të dhëna personale në një kontekst të tillë, do të shqyrtojmë mënyra për të kufizuar përmasën e zbulimit, për

shembull duke redaktuar të dhënat personale sa më shumë të jetë e mundur për të përmbushur kërkesën. Ne gjithashtu mund të zbulojmë të dhëna personale të këshilltarët tanë ligjorë kur është e nevojshme për të përfaqësuar ose këshilluar Hilti.

5. A do të transferohen të dhënat personale jashtë vendit dhe nëse po, si do të mbrohen ato?

Vendndodhjet e ruajtjes së të dhënave të Hilti zgjidhen për të mundësuar funksionimin efikas, për të përmirësuar performancën dhe për të krijuar kopje rezervë që mbrojnë të dhënat në rast ndërprerjeje ose problemi tjetër. Ne ndërmarrim hapa për të siguruar që të dhënat që mbledhim në bazë të kësaj Politike të Privatësisë të përpunohen në përputhje me dispozitat e saj dhe kërkesat e ligjit të zbatueshëm, kudo që ndodhen të dhënat.

Është politikë e Hilti që të ruajë të dhënat tuaja personale vetëm në vende ku ligji për mbrojtjen e të dhënave ofron të njëjtin nivel mbrojtjeje si në BE/EEA. Megjithatë, për shkak të disa operacioneve të biznesit, kufizimeve teknike ose rrethanave të tjera, ne mund të përpunojmë të dhënat tuaja personale jashtë vendit ku ndodheni. Në këto raste, zbatohen sa vijon:

Vendime për përshtatshmërinë: Disa marrës të vendosur jashtë EEA ndodhen në një vend për të cilin Komisioni Evropian ka lëshuar një vendim për përshtatshmëri. Në këtë rast, transferimi njihet si subjekt i një niveli të përshtatshëm mbrojtjeje të të dhënave nga perspektiva e ligjit evropian për mbrojtjen e të dhënave (neni 45 i GDPR) dhe për këtë arsye nuk nevojiten mekanizma shtesë për të mbrojtur të dhënat tuaja personale.

Mekanizma të tjerë transferimi: Marrës të tjerë të të dhënave tuaja personale ndodhen në vende për të cilat Komisioni Evropian **nuk ka lëshuar një vendim për përshtatshmëri**. Në këto raste, zbatohen këto:

a) Për transferime të brendshme midis entiteteve të Grupit Hilti:

Hilti ka miratuar Rregullat Detyruese të Korporatës ("BCR") për të lehtësuar transferimin e sigurt dhe në përputhje me ligjin të të dhënave personale midis entiteteve të Grupit Hilti. Prandaj, ne mund të mbështetemi te BCR të Hilti si një metodë e sigurt për transferimin e të dhënave, siç parashikohet në nenin 47 të GDPR.

Përveç BCR të Hilti, Hilti ka lidhur gjithashtu Klauzolat Standarde Kontraktuale për transferimin e të dhënave personale në vende të treta të datës 4 qershor 2021 ndërmjet të gjitha entiteteve të Grupit Hilti, për të siguruar transferim në përputhje me ligjin të të dhënave personale kur BCR e Hilti nuk do të konsiderohen si mekanizëm i vlefshëm.

b) Për transferime të jashtme jashtë Grupit Hilti:

Përmes lidhjes së marrëveshjeve të përshtatshme për transferimin e të dhënave të bazuara në Klauzola Standarde Kontraktuale sipas nenit 46(2)(c) të GDPR ose mjeteve të tjera adekuate, të cilat mund të aksesohen përmes detajeve të kontaktit të dhëna në seksionin 1 të kësaj Politike të Privatësisë, ne kemi vërtetuar që të gjithë marrësit e të dhënave të vendosur jashtë EEA do të ofrojnë një nivel të përshtatshëm mbrojtjeje për të dhënat personale dhe se masat përkatëse teknike dhe organizative për siguri janë në vend për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrimi aksidental ose i paligjshëm, humbja ose ndryshimi aksidental, zbulimi ose qasja e paautorizuar dhe nga çdo formë tjetër e përpunimit të paligjshëm. Çdo transferim i mëtejshëm (përfshirë edhe te degët tona jashtë EEA) i nënshtrohet kërkesave për transferim të mëtejshëm në përputhje me ligjin në fuqi.

Së fundi, në rrethana të jashtëzakonshme, Hilti mund të mbështetet te përjashtimet që transferimi i të dhënave tuaja personale është:

- (1) i nevojshëm për ekzekutimin e një kontrate ndërmjet jush dhe Hilti; ose
- (2) i nevojshëm për krijimin, ushtrimin ose mbrojtjen e kërkesave ligjore, në përputhje me nenet 49(1)(b) & (e) të GDPR dhe dispozitat përkatëse sipas ligjit vendor.

Hilti ka zbatuar Masa Teknike dhe Organizative, të cilat përcaktojnë masat dhe procedurat teknike dhe organizative të sigurisë që Hilti ndërmerr, minimalisht, për të ruajtur dhe mbrojtur sigurinë e të dhënave personale që përpunohen, përfshirë të dhënat në tranzit. Politika e Sigurisë Kibernetike dhe IT e Hilti është zhvilluar në përputhje me standardin ISO 27001.

6. Për çfarë qëllimesh i përdorim të dhënat personale?

Hilti është vazhdimisht në proces të përmirësimit të shërbimeve, faqeve të internetit dhe aplikacioneve të saj dhe ruan të dhënat personale vetëm për aq kohë sa është e nevojshme për qëllimet e përshkruara në këtë seksion dhe/ose sipas kërkesave ose lejeve të parashikuara nga ligji i zbatueshëm.

Tabela në vijim jep një përmbledhje të aktiviteteve të përpunimit të të dhënave personale në kuadër të shërbimeve, faqeve të internetit dhe aplikacioneve të Hilti, përfshirë qëllimin, llojin e të dhënave personale të përfshira dhe bazën ligjore për përpunimin.

	Qëllimi i Përpunimit	Kategoria e të Dhënave Personale të Përpunuara	Baza Ligjore për Përpunim
1	Për të ofruar, mirëmbajtur, mbrojtur, përmirësuar dhe zhvilluar shërbimet, faqet e internetit dhe aplikacionet tona, si dhe për të mbrojtur Hilti-n dhe klientët tanë.	• Identifikues dhe të dhëna kontakti • Të dhëna pajisjeje, përdorimi dhe teknike • Të dhëna vendndodhjeje • Të dhëna tregtare dhe transaksionesh • Të dhëna komunikimi	Përpunimi i të dhënave tuaja personale është: - i domosdoshëm për krijimin, zbatimin ose përmbushjen e një kontrate midis Hilti-t dhe klientëve tanë; ose - i nevojshëm për interesat legjitime të Hilti-t, siç është identifikimi juaj si klient, përshtatja e faqes së internetit sipas konfigurimeve tuaja, personalizimi dhe përmirësimi i përvojës suaj si klient, sigurimi i shërbimeve, faqeve të internetit dhe aplikacioneve tona, si dhe për mbrojtjen ligjore të Hilti-t ose për mbështetjen e hetimeve të brendshme.
2	Për të menaxhuar të gjitha pjesët e marrëdhënies kontraktore midis Hilti-t dhe klientëve tanë, duke përfshirë sigurimin e dorëzimit të porosive për produkte dhe shërbime të bëra përmes shërbimeve, faqeve të internetit dhe aplikacioneve, në bashkëpunim me transportuesit lokalë, kur është e zbatueshme.	• Identifikues dhe të dhëna kontakti • Të dhëna tregtare dhe transaksionesh • Të dhëna pajisjeje, përdorimi dhe teknike • Të dhëna komunikimi	Përpunimi i të dhënave tuaja personale është i nevojshëm për krijimin, zbatimin ose përmbushjen e një kontrate midis Hilti-t dhe klientëve tanë.
3	Për t'ju mundësuar përdorimin e shërbimeve, faqeve të internetit dhe aplikacioneve tona si përdorues i regjistruar.	• Identifikues dhe të dhëna kontakti • Të dhëna pajisjeje, përdorimi dhe teknike • Të dhëna tregtare dhe transaksionesh • Të dhëna komunikimi	Përpunimi i të dhënave tuaja personale për t'ju mundësuar përdorimin e shërbimeve, faqeve të internetit dhe aplikacioneve tona si përdorues i regjistruar është: - i bazuar në pëlqimin tuaj; - i nevojshëm për krijimin, zbatimin ose përmbushjen e një kontrate midis Hilti-t dhe klientëve tanë; ose - i nevojshëm për interesat legjitime të Hilti-t, siç është identifikimi juaj si klient, përshtatja e performancës së faqes me preferencat tuaja dhe personalizimi i përvojës suaj si përdorues.

	Qëllimi i Përpunimit	Kategoria e të Dhënave Personale të Përpunuara	Baza Ligjore për Përpunim
4	Për të parandaluar përdorimin abuziv ose të paligjshëm të produkteve, shërbimeve, faqeve të internetit, aplikacioneve dhe markës Hilti, për të siguruar përputhjen me detyrimet ligjore, për të mundësuar zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe zbatimin e marrëveshjeve tona.	- Identifikues dhe të dhëna kontakti - Të dhëna tregtare dhe transaksionesh - Të dhëna pajisjeje, përdorimi dhe teknike	Përpunimi i të dhënave tuaja personale është: - i nevojshëm për përmbushjen nga ana e Hilti-t të një detyrimi ligjor; ose - i nevojshëm për interesat legjitime të Hilti-t, siç është mbrojtja e pronësisë sonë intelektuale dhe informacionit tjetër tregtar si dhe mundësimi i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe zbatimi i marrëveshjeve tona.
5	Për të përgatitur dhe administruar trajnimet e porositura nga klienti dhe për t'i ofruar klientit, me kërkesë, regjistrime/certifikata të përfundimit të tyre.	- Identifikues dhe të dhëna kontakti - Të dhëna tregtare dhe transaksionesh - Të dhëna pajisjeje, përdorimi dhe teknike	Përpunimi i të dhënave tuaja personale është i nevojshëm për vendosjen, ekzekutimin ose realizimin e një kontrate ekzistuese midis Hilti dhe klientëve tanë.
6	Të përgjigjemi ndaj pyetjeve dhe kërkesave tuaja në lidhje me ofrimin e mbështetjes teknike apo shërbimeve të tjera për klientët, përfshirë edhe përmes telefonatave me shërbimin e klientit të Hilti ose platformave të komunitetit Hilti.	- Identifikues dhe të dhëna kontakti - Të dhëna pajisjeje, përdorimi dhe teknike - Të dhëna tregtare dhe transaksionesh - Të dhëna komunikimi	Përpunimi i të dhënave tuaja personale është i nevojshëm për interesat legjitime të Hilti për të trajtuar dhe për t'iu përgjigjur kërkesës përkatëse, e cila përndryshe nuk mund të përmbushej.
7	Që ta bëjmë faqen tonë të internetit më të përshtatshme për përdoruesit dhe për të fituar njohuri mbi sjelljen e përdorimit nga vizitorët e faqes dhe përdoruesit e aplikacioneve dhe softuerëve tanë, në mënyrë pseudonime dhe përmes pajisjeve të ndryshme, për qëllime reklamuese dhe kërkime tregu, si dhe për të mundësuar personalizimin e përmbajtjes së faqes në përputhje me preferencat individuale. Për të kryer analiza, për të gjeneruar modele të shitjeve dhe trafikut, si dhe për të analizuar dhe përmirësuar efektivitetin e reklamimit, si në mënyrë anonime (p.sh., duke agreguar të dhënat) ashtu edhe në nivel individual (nëse lejohet ligjërisht).	- Identifikues dhe të dhëna kontakti - Të dhëna pajisjeje, përdorimi dhe teknike - Të dhëna tregtare dhe transaksionesh - Të dhëna komunikimi	Përpunimi i të dhënave tuaja personale për të kryer analiza të përdorimit dhe sjelljes në nivel individual për qëllime reklamuese dhe kërkimi tregu bazohet në pëlqimin tuaj. Përpunimi i të dhënave tuaja personale për të gjeneruar dhe transmetuar lista audiencash bazohet në interesat legjitime të Hilti për zhvillimin efektiv të fushatave reklamuese dhe për të synuar audiencën përkatëse.

	Qëllimi i Përpunimit	Kategoria e të Dhënave Personale të Përpunuara	Baza Ligjore për Përpunim
	Për të gjeneruar dhe transmetuar lista audiencash tek partnerët tanë të besuar të reklamimit për fushata reklamuese (shih seksionin 4 për më shumë informacion lidhur me ndarjen e të dhënave).		
8	Për të kryer kërkime me klientët, përfshirë kërkime të përgjithshme të tregut ose anketime për nevojat dhe opinionet e klientëve tanë mbi produkte dhe tema specifike, për të mbledhur dhe analizuar reagimet e klientëve lidhur me përvojën e tyre me shërbimet, faqen e internetit ose aplikacionet tona. Nëse jeni i/e përzgjedhur për një anketë, do t'ju dërgohet ajo përmes njëres prej kanaleve që përdorim për marketingun direkt, të përshkruara në qëllimin 11.	• Identifikues dhe të dhëna kontakti • Të dhëna tregtare dhe transaksionesh • Të dhëna komunikimi	Përpunimi i të dhënave tuaja personale: - bazohet në pëlqimin tuaj; ose - është i nevojshëm për mbledhjen dhe analizën e feedback-ut të klientit për interesin legjitim të Hilti për të përmirësuar produktet dhe shërbimet tona bazuar në përvojën dhe opinionin e klientit.**
9	Për të vlerësuar përputhshmërinë tuaj me lloje të caktuara ofertash, produkteve ose shërbimeve.	• Identifikues dhe të dhëna kontakti • Të dhëna tregtare dhe transaksionesh	Përpunimi i të dhënave tuaja personale: - bazohet në pëlqimin tuaj; ose - mund të jetë i nevojshëm për interesin legjitim të Hilti-t për t'u siguruar që ju ofrojmë informacion të saktë lidhur me përputhshmërinë tuaj për oferta, produkte, ose shërbime të caktuara.
10	Për të komunikuar me ju për çështje të tjera (p.sh., për të dërguar kujtesa, njoftime teknike, përditësime, informacione mbi ndryshimet e ardhshme në shërbimet tona, alarme sigurie, mesazhe mbështetjeje dhe administrative, ose njoftime shërbimi).	• Identifikues dhe të dhëna kontakti • Të dhëna tregtare dhe transaksionesh • Të dhëna komunikimi (varësisht nga kanali)	Përpunimi i të dhënave tuaja personale: - është i nevojshëm për interesin legjitim të Hilti-t për t'ju ofruar informacion thelbësor lidhur me përdorimin tuaj të shërbimeve, faqeve të internetit dhe aplikacioneve të Hilti-t; ose - bazohet në detyrimin ligjor të Hilti-t në kontekstin e sigurisë së produktit.

	Qëllimi i Përpunimit	Kategoria e të Dhënave Personale të Përpunuara	Baza Ligjore për Përpunim
